



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2148 prot.

Vlorë, më 21.02 2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_, 2023

**“PËR KORRIGJIMIN E EMËRTIMIT TË NJË RRUGE NË TERRITORIN E  
BASHKISË VLORE”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1 , pika 1.1/b pika 2, 9, neni 54 pika II, neni 55 pika 2 , kërkesën e Shoqatës “ Atdhetare – Kulturore Velca “ me nr . 17, datë 11.09.2019 si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_,


**VENDOSI:**

1. Të korrigjojë emërtimin e rrugës në anën perëndimore të Universitetit “Ismail Qemali” nga “Yzeir Skëndaj ” në “ Yzeir Skëndo Ilazaj”.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

Konceptoi: S. Haxhira

KRYETARË

Dritan Leli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 2148 prot.

Vlorë, më 20.02 2023

RELACION

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR KORRIGJIMIN E EMËRTIMIT TË NJË RRUGE  
NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Ky projektvendim është hartuar bazuar në kërkesën e Shoqatës “Atdhetare-Kulturore Velca” me nr . 17, datë 11.09.2019 dhe gjen bazë në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9, neni 54 pika ll, neni 55 pika 2 .

Është konstatuar se rruga në anën perëndimore të Universitetit “Ismail Qemali” që mban emrin “Yzeir Skëndaj “ ka pasaktësi në emërtim : mungon mbiemri real “ Ilazaj” , atësia “Skëndo” jepet gabimisht si mbiemër “ Skëndaj”.

Emërtimi i saktë që duhet të mbajë kjo rrugë ( sipas përshkrimit dhe përcaktimeve në kërkesën e lartpërmendur ) është **YZEIR SKËNDO ILAZAJ** .

Yzeir Skëndo Ilazaj ka qënë mësues dhe në vitet para Luftës së Vlorës , u bë pjesëmarrës veprues i shoqërisë “ Mbrojtja shkollore” dhe përgjegjës i degës së saj për Velcën.

Luftëtar zemërzjarrë i Epopesë më 1920 dha jetën për çlirimin e qytetit të Vlorës duke u bërë i vetmi mësues-dëshmor në këtë luftë .

Nga sa më lart është në vlerësimin dhe nderin tuaj të miratoni ndryshimin e emërtimit të kësaj rruge nga Yzeir Skëndaj “ në “ Yzir Skëndo Ilazaj ”.

Konceptoi: S.Haxhiraj

**KRYETARI**

**Dritan Leli**

